



REPUBLIKA E SHQIPERISË
KËSHILLI BASHKIAK
GRAMSH

Nr. 2038/prot.
3.

Gramsh, më 07 / 08 / 2023

VENDIM

Nr. 59 , datë 04.08.2023

VENDIM

“PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT TEKNIK “ RIKONTRUKSION I GJIMNAZIT SHEFQET GUZI”.”

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 04.08.2023, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Burimeve Natyrore, për “Projektin e Rikontruksionit të Gjimnazit Shefqet Guzi”, bazuar në ligjin Nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 41, pika 2/ç, Ligji Nr. 68 datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjs vendore”, Ligjin Nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligji Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM –së Nr. 285 datë 19.05.2021” Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar neni 12 dhe 13i tij, VKB Nr. 103 datë 27.12.2022 “Mbi miratimin e programit buxhetor për vitin 2023 të Bashkisë Gramsh”, si dhe shkresës Nr.3124/5Prot, datë 09.06.2023 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit me lëndë “ Dërgohet çelja e fondeve në grupin e shpenzimeve kapitale për projektet me cikël financimi 2023 – 2024,

V E N D O S I:

1. Të miratojë projektin “Rikontruksioni i gjimnazit Shefqet Guzi “ **në vlerën totale 80 595 188** (tetëdhjetë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e tetë) lekë.
2. Vlera e financimit prej **20 589 278** (njëzetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë do të financohet nga buxhet i bashkisë i ndarë në :
 - viti 2023 në vlerën 2 000 000 (dy milion) lekë.
 - viti 2024 në vlerën 18 589 278 (tetëmbëdhjetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë.
 - Të pakësohet vlera prej 2 000 000 (dy milion) lekë nga shuma e përcaktuar me vendimin e këshillit bashkiak Nr. 103, datë 27.12.2022 “ Për miratimin e programit buxhetor për vitin 2023”, pasqyra nr. 2 me zërin bashkëfinacime për investime.
 - Të shtohet shuma 2 000 000 lekë në projektin e sipërpërmendur.
3. Vlera e financimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit do të jetë **60 005 910** (gjashtëdhjetë milion e pesë mijë e nëntëqind e dhjetë) lekë e ndarë në :
 - viti 2023 në vlerën 30 002 955 (tridhjetë milion e dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë.

- viti 2024 në vlerën 30 002 955 (tridhjetë milion e dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

ENIS ZANI



Konceptoi: Xh. Gjini
Miratoi: E. Zani
Dosja nr: _____
A fati i ruajtjes: _____